



Objektivat tona

© Blue World Institute

Në Detin Adriatik jetojnë disa lloje cetacesh dhe breshkash detare. Individët e rinj të breshkave detare e shfrytëzojnë këtë det si habitat të rëndësishëm ushqimi dhe rritjeje. Fatqësisht, cetacetë dhe breshkat detare janë të rrezikuara nga aktivitetet e njeriut, veçanërisht nga peshkimi dhe turizmi bregdetar (si p.sh. ndikimet nga mjetet e lundrimit).

Objektivi kryesor i projektit NETCET është zhvillimi i strategjive të përbashkëta për ruajtjen e cetaceve dhe breshkave detare në Adriatik nëpërmjet bashkëpunimit rajonal (**bashkëpunimi mbarë-Adriatik**). Cetacetë dhe breshkat detare janë trashëgimi natyrorë e kërcënuar dhe e përbashkët në rajon, e cila nuk mund të menaxhohet nga një vend i vetëm që vepron i izoluar. Për shkak të sjelljes migratore të këtyre llojeve dhe përgjegjësi të përbashkëta të vendeve të Adriatikut, bashkëpunimi mes këtyre vendeve ka rëndësi themelore për planifikimin efektiv të **strategjive afatgjata të ruajtjes** së këtyre llojeve.

Problemet e ruajtjes së biodiversitetit detar dhe në mënyrë të veçantë çështjet që lidhen me **ruajtjen e cetaceve dhe breshkave detare** janë të përbashkëta mes të gjithë vendeve të Adriatikut. Nga ana tjetër, përvojat mund të jenë të ndryshme mes rajoneve të ndryshme, prandaj mund të arrihen rezultate mjaft të mira nëse **integrohen së bashku praktikatat dhe përvojat më të mira**, me qëllim përcaktimin e një kuadri të përbashkët masash dhe mjeteve për ruajtjen e llojeve detare të kërcënuara, duke i bërë këto masa të vlefshme dhe të përdorshme për rajone të tjera. Për këto arsye, projekti NETCET, i koordinuar nga Bashkia e Venecias, zbatohet nga 13 partnerë nga vende të ndryshme të basenit të Adriatikut: **Itali, Kroaci, Shqipëri, Mali i Zi dhe Slloveni**.

Projekti NETCET zbatohet në periudhën Tetor 2012 – Shtator 2015.

Programi IPA Adriatik CBC

Projekti NETCET financohet nga Programi IPA Adriatik CBC dhe përfshihet në Prioritetin 2 "Burimet Natyrore dhe Kulturore dhe Parandalimi i Rreziqeve". Qëllimi kryesor i këtij programi bashkëpunimi ndërkufitar është forcimi i kapaciteteve për një zhvillim të qëndrueshëm të rajonit të Adriatikut, nëpërmjet një strategjie të përbashkët aktivitetesh midis vendeve partnere të këtij rajoni.

Faqja web e projektit: www.adriaticpacbc.org



Çfarë synojmë të arrijmë

© Photo by G. Culmone



› Një **Rrjet Qytetesh** për rritjen e rolit të qyteteve të Adriatikut në ruajtjen e cetaceve dhe breshkave detare. Një **Rrjet Teknik** për shkëmbimin e ekspertizës;



› Një kuadër i përbashkët i grumbullimit të të dhënave, bazuar në një listë të përbashkët të të dhënave minimale të detyrueshme, e grumbulluar nga të gjithë grupet që punojnë në rajonin e Adriatikut në një **databazë të përbashkët unike**, e lidhur me databazat ekzistuese kombëtare dhe ndërkombëtare për **cetacetë dhe breshkat detare**;



› **Kurse trainimi dhe workshop** të posaçëm për shkëmbim përvoja mes partnerëve dhe organizatave (si p.sh. për procedurat e përbashkëta të ekzaminimeve klinike dhe workshop për ngritjen e qendrës së shpëtimit);



› **Ngritja ose përmirësimi i qendrave të shpëtimit të breshkave detare** në vendndodhje strategjike. Qendrat e shpëtimit do të jenë vende të përhershme të ekspertizës për autoritetet dhe të gjithë të interesuarit, të cilat janë gjithashtu edhe qendra të rëndësishme edukimi;



› Propozimi për ngritjen e një **Task Force të Emergjencave në Adriatik, për të ndërhyrë në rastet e daljes në breg të cetaceve dhe breshkave detare, si dhe në rastet e tjera të emergjencave mjedisore**;



› Një **program i koordinuar monitorimi** për shtimin e të dhënave dhe rritjen e shkallës së njohjes mbi ruajtjen e cetaceve dhe breshkave detare (p.sh. do të synohet që 25 breshkave t'u vendosen gjurmues dixhital);



› Një seri **aktivitetesh ndërgjegjësuere me peshkatarë, varkëtarë, nxënës shkollash dhe publikun e përgjithshëm** për rritjen e ndërgjegjes mbi praninë dhe nevojat e ruajtjes së cetaceve dhe breshkave detare (p.sh. WWF Itali do të përgatisë materiale edukative për nxënësit e shkollave);




› Dy **strategji të përbashkëta për cetacetë dhe breshkat detare**, të cilat parashikojnë aktivitete që adresojnë kërcënimet kryesore të popullatave të Adriatikut (p.sh. prezantimi i Planeve Kombëtare të Veprimit për cetacetë dhe breshkat detare në Konferencën Përfundimtare të projektit).



Metoda e punës tonë

© Blue World Institute





Rezultatet e pritshme

- › **Njohuri shkencore të standartizuara dhe bashkëpunim efikas** midis organizatave të përfshira në ruajtjen e cetaceve dhe breshkave detare në Adriatik;
- › **Kapaciteti i rritur institucional për ruajtjen e cetaceve dhe breshkave detare** në vendet partnere;
- › Rritje e njohurive mbi ruajtjen e popullatave të cetaceve dhe breshkave detare të Adriatikut, hot-spotëve dhe kërcënimet kryesore;
- › **Kapaciteti i rritur teknik për shërimin e breshkave detare në Adriatik** dhe trajtim efikas i breshkave të plagosura në struktura të nivelit të lartë, si dhe rritje e informacionit për publikun në qendrat e shpëtimit;
- › **Rritje e ndërgjegjes së komuniteteve bregdetare mbi praninë dhe nevojat e ruajtjes së cetaceve dhe breshkave detare**, si dhe përvetësimi nga peshkatarët i procedurave për trajtimin e duhur të këtyre llojeve;
- › Përmirësimi i ruajtjes dhe menaxhimit të cetaceve dhe breshkave detare, si dhe i habitateve të tyre në Adriatik nëpërmjet **bashkëpunimit rajonal efikas**;
- › **Kultivimi i sensit të pasurisë** dhe krenarisë për trashëgiminë natyrore të Adriatikut.

Partnerët

- › Bashkia e Venecias, Itali – koordinatori i projektit
- › Universiteti i Padovas – Departamenti i Biomjekësisë së Krahasuar dhe Shëndetit Ushqimor, Itali.
- › Bashkia e Peskarës, Itali.
- › Fondacioni Cetacea, Itali.
- › Instituti Kombëtar Italian për Kërkim dhe Mbrojtje Mjedisi, Itali.
- › Instituti Shtetëror për Mbrojtjen e Mjedisit, Kroaci.
- › Instituti "Blue World" për Kërkimin dhe Mbrojtjen e Detit, Kroaci.
- › Shoqata e Herpetofaunës Shqiptare, Shqipëri.
- › Shoqata e Mbrojtjes së Gjallesave Ujore të Shqipërisë, Shqipëri.
- › Instituti i Biologjisë Detare, Kotor, Mali i Zi.
- › Universiteti i Primorska, Qendra e Kërkimit Shkencor, Koper, Slloveni.
- › WWF Itali.
- › Qendra për Edukimin Detar, Pula, Kroaci.

Shoqërues

- › Instituti për Mbrojtjen e Natyrës i Republikës së Sllovenisë, Slloveni.
- › Rajoni Veneto – Departamenti i Pyjeve dhe Parqeve, Itali.
- › Rajoni Emilia Romanja – Drejtoria e Përgjithshme e Mbrojtjes së Mjedisit, Tokës dhe Bregdetit, Itali.
- › Rajoni Marke – Rrjeti ekologjik rajonal për mbrojtjen e biodiversitetit, Itali.

Kontakte

Shoqata e Mbrojtjes së Gjallesave Ujore të Shqipërisë
s_beqiraj@yahoo.com / T +355684030613

Shoqata e Herpetofaunës Shqiptare
idriz_haxhiu@yahoo.com / T +355682003235

projekti NETCET

Rrjeti për Ruajtjen e Cetaceve dhe Breshkave Detare në Adriatik

Bashkia e Venecias

Divizioni i Zhvillimit Ekonomik,
Politikave Evropiane dhe Planit Strategjik
T +39 041 274 7826 / 7830 / 7834
info@netcet.eu | www.netcet.eu | www.facebook.com/NETCETproject

Kjo fletëpalosje është prodhuar me mbështetjen financiare të Programit IPA Adriatik për Bashkëpunimin Ndërkufitar. Përmbajtja e kësaj fletëpalosjeje është nën përgjegjësinë e vetme të Bashkisë së Venecias dhe nuk pasqyron detyrimisht pikëpamjet e Programit IPA Adriatik për Bashkëpunimin Ndërkufitar.

netcet

NETCET projekti

Rrjeti për Ruajtjen e Cetaceve dhe Breshkave Detare në Adriatik



The project is co-funded by the European Union, Instrument for Pre-Accession Assistance.

 WEBSITE WWW.NETCET.EU